



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 13.11.2018

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 92/2014, “PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”
(shqyrtimi në parim)

HYRJE

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, shqyrtoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, në mbledhjet e datave 6,7,8,9, dhe 13 nëntor 2018.

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin e shqyrton këtë projektligj në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, bazuar në Kalendarin e posaçëm të Kuvendit për shqyrtimin e projektbuxhetit të shtetit të vitit 2019 dhe projektligjeve financiare që kanë lidhje me të.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputetin Ilir Beqaj relator për shqyrtimin e këtij projektligji.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, është një nismë e Këshillit të Ministrave, e cila i paraqitet për shqyrtim Kuvendit bazuar në përcaktimet e nenit 78, 83, pika 1 dhe 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ky projektligj është pjesë e paketës fiskale 2019.

Projektligji shoqërohet nga relacioni shpjegues, sipas përcaktimeve të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Të pranishëm në mbledhjet e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin Z. Erion Luçi, zëvendësministër i ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

I. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

➤ Ndryshimet e propozuara në projektligj synojnë:

1. Nxitjen dhe lehtësimin e investimeve në fushën e digjitalizimit të medieve audiovizive;

Për këtë qëllim propozohet aplikimi i shkallës së reduktuar të TVSH-së, prej 6% , edhe për furnizimin e shërbimit të reklamave nga media audiovizive (televizionet). Aktualisht furnizimi (shitja) i shërbimit të reklamave nga media elektronike është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, sipas shkronjës “j”, të nenit 53, të ligjit “Për TVSH-në”, dhe në zbatim të dispozitave të këtij ligji, këto subjekte nuk mund të zbresin TVSH-në e paguar në blerjet brenda vendit dhe në import, të kryera në funksion të furnizimeve të përjashtuara, ndryshe nga subjektet që kryejnë furnizime të tatueshme dhe zbresin TVSH-në e paguar në blerje. TVSH-ja e paguar në blerjet brenda vendit dhe në import, në këtë rast, është kosto për mediet.

2. Nxitjen dhe zhvillimin e “transportit publik të gjelbër”, duke zëvendësuar autobusët e transportit publik me naftë me autobus elektrikë.

Për këtë qëllim propozohet aplikimi i shkallës së reduktuar të TVSH-së, prej 10%, për furnizimin e shërbimit të transportit publik të udhëtarëve me autobus elektrikë. Transporti rrugor është një kontribues mjaft i madh i ndotjes së ajrit dhe mjedisit. Kjo ndotje e madhe çon në kërkimin e të ashtuquajturit “Transport të gjelbër”, që do të thotë çdo lloj praktike e transportit apo automjet, që është eko-miqësore dhe që nuk ka ndikim negativ në mjedis. Një nga mënyrat e transportit të gjelbër është e lidhur pikërisht me transportin publik me autobus, nëpërmjet zëvendësimit të autobusëve me naftë me autobusë elektrikë.

3. Mbështetjen e sektorit bujqësor, duke lehtësuar kostot e investimit;

Për këtë qëllim propozohet që furnizimi i makinave bujqësore të jetë furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, jo vetëm në import por edhe brenda vendit, sipas po të njëjtës listë makinash bujqësore, të miratuar me Këshillit të Ministrave nr. 953/2014, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Aktualisht, sipas pikës 41, të nenit 56, të ligjit “Për TVSH-në”, importimi i makinave bujqësore është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja. Duke qenë se tashmë furnizimi i makinave bujqësore do të jetë i përjashtuar si në import ashtu dhe kur shitet brenda vendit, për të gjithë personat, propozohet që ky furnizim të përfshihet në listën e furnizimeve të përjashtuara brenda vendit (neni 53 i ligjit për TVSH-në) dhe si i tillë në zbatim të pikës 1, të nenit 56, të ligjit, është furnizim i përjashtuar dhe në import. Për rrjedhojë, hiqet parashikimi sipas pikës 41, të nenit 56, që përcakton përjashtimin e makinave bujqësore vetëm në import.

4. Adresimin e kërkesës së industrisë fasone për përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar;

Për këtë qëllim propozohet përfshirja e shërbimit të përpunimit të mallrave joshqiptare të destinuara për t'u rieksportuar, të kryera nga nënkontraktorët për llogari të shoqërisë së përpunimit aktiv që e ka kontraktuar furnizimit, në listën e furnizimeve të përjashtuara nga TVSH-ja.

Gjithashtu, parashikohet që ministri përgjegjës për financat të përcaktojë me udhëzim dokumentacionin e nevojshëm për zbatimin e përjashtimit. Aktualisht furnizimi i shërbimit të përpunimit të mallrave joshqiptare të destinuara për t'u rieksportuar, të kryera nga nën kontraktorët për llogari të shoqërisë së përpunimit aktiv që e ka kontraktuar, është furnizim i tatueshëm me shkallën standarde 20 për qind, ndërkohë që më herët ky furnizim ka qenë i përjashtuar nga TVSH-ja.

5. Zhvillimin e industrisë vendase të prodhimit të barnave, duke lehtësuar koston e lëndëve të para për prodhimin e tyre.

Për këtë qëllim propozohet që importimi i lëndëve të para që përdoren për prodhimin e barnave, të kryera nga mbajtësit e autorizimit të prodhimit, sipas legjislacionit të fushës për barnat, të jetë furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja. Ndërkohë që, nuk e përfitojnë përjashtimin nga TVSH-ja lëndët e para që janë me përdorim të dyfishtë. Gjithashtu, parashikohet që lista e lëndëve të para për prodhimin e barnave, të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Aktualisht furnizimi i barnave është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja, si brenda vendit dhe në import, në përputhje me nenin 51, të ligjit “Për TVSH-në” dhe si i tillë, për këto furnizime, subjektit që i kryen ato, nuk i lind e drejta e zbritjes së TVSH-së. TVSH-ja e paguar në këtë rast është kosto.

➤ EFEKTET E PRITSHME NË BUXHET

Sipas përcaktimeve në relacionin që shoqëron projektligjin, projektligji paraqet efekte buxhetore, të cilat përafërsisht vlerësohen në masën minus 300 000 000 (treqind milionë) lekë, por që parashikohet të sjellë efekte pozitive në zhvillimin e sektorëve që preken nga parashikimet e tij.

II. PROCESI I SHQYRTIMIT NË KOMISIONIN PËR VEPRIMTARITË PRODHUESE, TREGTINË DHE MJEDISIN

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin e shqyrtoi projektligjin në mbledhjet e datave 6,7,8, 9 dhe 13 nëntor 2018.

Të pranishëm në mbledhjet e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve të deputetëve ishin përfaqësues të ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Pas prezantimit të detajuar të projektligjit nga relatori i caktuar nga Komisioni, përfaqësuesit e ministrisë në mënyrë të përmbledhur prezantuan synimet e projektligjit, argumentuan në aspektin e politikave

fiskale ndryshimet e propozuara dhe efektet e pritshme që këto ndryshime do të kenë në buxhetin e shtetit.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit, Komisioni zhvilloi një seancë dëgjimore me përfaqësues të disa grupeve të interesit, si: Shoqata Shqiptare e Investitorëve të Huaj (FIAA), Shoqata Kombëtare e Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë dhe Shoqata e Ricikluesve.

Në diskutimin e tyre përfaqësuesit e shoqatës së Transportit Qytetas trajtuan shqetësimet lidhur me problematikat me të cilat ndeshet aktualisht ky shërbim, të cilat vijnë kryesisht si pasojë e rritjes së çmimit të naftës. Për këtë arsye ata propozuan që të njihet si TVSH e zbritshme e gjithë vlera e TVSH-së së paguar për blerjen e karburantit.

Në diskutimet e tyre anëtarët e Komisionit diskutuan lidhur me përfitimet që do të ketë mjedisi nga propozimi i nismës për zhvillimin e “transportit publik të gjelbër”, e cila synon zëvendësimin e atobusëve me naftë të transportit publik me autobusë elektrikë. Propozimi për aplikimin e shkallës së reduktuar të TVSH-së, prej 10%, për furnizimin e shërbimit të transportit publik të udhëtarëve me autobus elektrikë do të ketë ndikime financiare në buxhetin e shtetit, por nga ana tjetër do të kontribuojë për uljen e nivelit të ndotjes në mjedis. Për këtë qëllim, anëtarët e Komisionit diskutuan për mundësinë e shtrirjes së aplikimit të shkallës së reduktuar të TVSH-së prej 10% edhe për shërbimin e taksive.

Një çështje e rëndësishme e diskutuar në Komision ishte dhe ajo lidhur me mundësinë e heqjes së TVSH-së për inputet bujqësore, por pa hequr TVSH-në e rimbursueshme për fermerët sipas skemës për mbështetjen e fermerëve, propozim ky i paraqitur nga ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Anëtarët e Komisionit argumentuan se inputet bujqësore nuk duhet jenë të përjashtuara nga TVSH-ja, por TVSH-ja për këtë kategori të reduktohet në masën nga 0 - 6%. Pra është e nevojshme të ketë një vlerë TVSH-je, qoftë kjo edhe zero, pasi kontribuon në zbutjen e informalitetit, forcimin e ekonomisë dhe siguron garancinë e produkteve bujqësore. Deputetët vlerësuan se aplikimi i një shkalle të reduktuar TVSH-je për inputet bujqësore duhet të shoqërohet edhe me ndryshime në ligjin për inputet bujqësore, për ta lidhur lëvizjen e tyre me një sistem gjurmueshmërie, cili do të ndikojë edhe në garantimin e cilësisë së produktit.

Këto propozime mbeten të hapura për t’u diskutuar në fazën e shqyrtimit nen për nen të projektligjit.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni u shpreh dakord, në parim, për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk ishin të pranishëm.

RELATOR

KRYETAR

Ilir BEQAJ

Eduard SHALSI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 23.11.2018

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 92/2014, “PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”
(shqyrtimi nen për nen)

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 23 nëntor 2018, shqyrtoi nen për nen projektligjin ““Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin e shqyrton këtë projektligj bazuar në Kalendarin e posaçëm të Kuvendit për shqyrtimin e projektbuxhetit të shtetit të vitit 2019 dhe projektligjeve financiare që kanë lidhje me të.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit ishin përfaqësues të ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Ky projektligj synon:

- nxitjen dhe lehtësimin e investimeve në fushën e digjitalizimit të medieve audiovizive;
- nxitjen dhe zhvillimin e “transportit publik të gjelbër”, duke zëvendësuar autobusët e transportit publik me naftë me autobus elektrikë;
- mbështetjen e sektorit bujqësor, duke lehtësuar kostot e investimit;
- adresimin e kërkesës së industrisë fasone për përjashtim nga tatimi mbi vlerën e shtuar;
- zhvillimin e industrisë vendase të prodhimit të barnave, duke lehtësuar koston e lëndëve të para për prodhimin e tyre.

Sipas përcaktimeve në relacionin që shoqëron projektligjin, projektligji paraqet efekte buxhetore, të cilat përafërsisht vlerësohen në masën minus 300 000 000 (treqind milionë) lekë, por që parashikohet të sjellë efekte pozitive në zhvillimin e sektorëve që preken nga parashikimet e tij.

Gjatë diskutimit të projektligjit në Komision, anëtarët e Komisionit diskutuan lidhur me përfitimet që do të ketë mjedisi nga propozimi i nismës për zhvillimin e “transportit publik të gjelbër”, e cila synon zëvendësimin e autobusëve me naftë të transportit publik me autobusë elektrikë. Propozimi për aplikimin e shkallës së reduktuar të TVSH-së, prej 10%, për furnizimin e shërbimit të transportit publik

të udhëtarëve me autobus elektrikë do të ketë ndikime financiare në buxhetin e shtetit, por nga ana tjetër do të kontribuojë për uljen e nivelit të ndotjes në mjedis. Për këtë qëllim, anëtarët e Komisionit mbështetën propozimin për shtrirjen e aplikimit të shkallës së reduktuar të TVSH-së prej 10% edhe për mjetet e tjera që ofrojnë shërbim taksit.

Një çështje e rëndësishme e diskutuar në Komision ishte dhe ajo lidhur me mundësinë e heqjes së TVSH-së për inputet bujqësore, por pa hequr TVSH-në e rimbursueshme për fermerët sipas skemës për mbështetjen e fermerëve, propozim ky i paraqitur nga ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Anëtarët e Komisionit argumentuan se inputet bujqësore nuk duhet jenë të përjashtuara nga TVSH-ja, por TVSH-ja për këtë kategori të reduktohet në masën nga 0 - 6%. Pra është e nevojshme të ketë një vlerë TVSH-je, qoftë kjo edhe zero, pasi kontribuon në zbutjen e informalitetit, forcimin e ekonomisë dhe siguron garancinë e produkteve bujqësore. Deputetët mbështetën propozimin për aplikimin e një shkalle të reduktuar TVSH-je për inputet bujqësore, duke theksuar se është e nevojshme që kjo masë të shoqërohet edhe me ndryshime në ligjin për inputet bujqësore, për ta lidhur lëvizjen e tyre me një sistem gjurmueshmërie, cili do të ndikojë edhe në garantimin e cilësisë së produktit.

Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni vendosi t'i paraqesë Komisionit për Ekonominë dhe Financat propozimet si më poshtë:

1. Në nenin 1 të projektligjit , pika 7 që shtohet, të riformulohet si vijon:

“7. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e mjeteve të transportit publik të udhëtarëve me autobus me dhjetë vende ose më shumë, si dhe për furnizimin e mjeteve që përdoren për shërbimin e transportit taksit, vetëm me motor elektrik, është 10 për qind.”.

2. Pas nenit 4 të shtohet neni 4/1 si më poshtë:

“Neni 4/1

Pas nenit 62, të shtohet neni 62/1 me përmbajtje si vijon.

Neni 62/1

Importimi dhe furnizimi i plehrave kimikë, pesticideve, farërave dhe fidanëve

Importimi dhe furnizimi i plehrave kimikë, pesticideve, farërave dhe fidanëve që përdoren në bujqësi, janë furnizime me shkallë TVSH-je 0% .

RELATOR

KRYETAR

Ilir BEQAJ

Eduard SHALSI